# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475069**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbyll sytë përgjithmonë në moshën 75-vjeçare aktori i estradës së Lushnjës, miku zbulon kërkesën e fundit të Robert Kamanit |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/kultureart/mbyll-syte-pergjithmone-ne-moshen-75-vjecare-aktori-i-estrades-se-lus-i402157` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 06:20:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 06:08:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `64437ca3cabddcc0da02d1db21121ac0e97e9916ce097c9b078446e72306fb6a` |
| TEKSTI | `b7514126fe958ff16deda79bab703805d64dea68ad481d0e3d5770bdbd704ea5` |
| PAMJA | `e0091359f8a0628a083711b0b8b37542735dc389e310707cdd8e5502212946c3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d92517be4ab80072031e4cf2a8c88dbee048ec1eba0540cb0e8b9bb5849222e4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2fad39eb4a5630a03d13ec48550b069ca76ccbe736c7b94b7af60112a505f929` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d92517be4ab80072031e4cf2a8c88dbee048ec1eba0540cb0e8b9bb5849222e4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Kulture & Art

28 Shtator 2026, 08:08

# Mbyll sytë përgjithmonë në moshën 75-vjeçare aktori i estradës së Lushnjës, miku zbulon kërkesën e fundit të Robert Kamanit

Shkruar nga **Newsbomb**



Robert Kamani

Një lajm i trishtë ka mbërritur së fundmi nga bota e artit pasi mësohet se është ndarë nga jeta në moshën 75-vjeçare aktori i njohur i estradës së Lushnjës, Robert Kamani. Lajmin e kobshëm e kanë bërë me dije miqtë e aktorit, të cilët zemërthyer kanë njoftuar për largimin nga jeta të Kamanit.

Përmes një reagimi prekës, ku sjell në kujtesë takimin e fundit me Robert Kamanin, miku i tij Fatbardh Rustemi shkruan se mosha dhe asgjë nuk ia ndaloi ecjen dhe të qenurit aktiv në skenë, postime dhe tavolinat me miqtë e tij. Sakaq, mësohet se aktori, ndonëse ndër vite udhëtoi botën, frymën e fundit e dha në Shqipëri, në atdheun e tij që ai e deshi kaq shumë dhe kontribuoi për të deri në ditën e fundit të jetës së tij.

Ndërsa zbulohet se kërkesa e tij e fundit ishte redaktimi i poezive të tij, që ia kishte besuar Fatbardh Rustemit.

*"Një lajm shokues sapo më erdhi nga Shqipëria: shoku im i vjetër, aktori i njohur i estradë së Lushnjës, Robert Kamani, u nda nga jeta, që e deshte aq shumë. Të vetmin nder, që i bëri vdekja: nuk e mori në Amerikë, as në Turqi, ku festoi 75-vjetorin e ditëlindjes me familjarët, por, në atdhe.*

*Pesha e moshës nuk ia ngadalsoi ecjen. Largësia s'e pengoi të ishte i pranishëm në hallet e vendit, duke qenë aktiv në postimet e tij. Humori, që dikur e jepte për publikun në skenë, do e shoqëronte në tavolinë me miqtë.*

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit



Bota
Çmimet e naftës rriten ndjeshëm në tregun global, Trump i prerë: Sapo SHBA-të të fitojnë luftën, do të kemi kosto të reja



Aktualitet
Fillimjavë "e furishme"! Begaj mbledh socialistët te Pallati i Brigadave, pas diskutimeve për Hysenin, mazhoranca "zhvendoset" në Kuvend për takim me europianët

Zbulo më shumë artikuj

*U takuam, së fundi, dhe në Tiranë, ku më kërkoi t'i redaktoja një përmbledhje me të gjitha poezitë e shkruara. Ky ishte plani i tij i së ardhmes, duke e bërë dhe më të rëndë humbjen e tij. Në poezi përshkruan jetën, ashtu sikurse e bëri: të vrullshme, nga një djalosh i dashuruar deri tek emigranti udhëve të botës. Nga skena ku tallej me veset e shoqërisë deri në Akropol, ku një natë fjeti me perënditë.",* shkruan Fatbardh Amursi Rustemi.

Ikja e aktorit të njohur të Lushnjës ka lënë pas një boshllëk për të gjithë miqtë, kolegët e njerëzit që e njohën ndër vite për rolet e tij të spikatura në skenë, por më së shumti për familjen e tij, bashkëshorten Diana, djalin Rodi dhe mbesat e nipërit.

Kamani e nisi karrierën e tij si aktor shfaqje si komedia "Tre magjistarët" (në rolet kryesore alokuar me artistë të tjerë si Roland Lushnjari dhe Flamur Shabani) dhe aktivitete të Shtëpisë së Pionierit në Lushnjë.

Më vonë u bë dhe pjesë e trupës ku interpretoi në dhjetëra premiera, skeçe dhe parodi, shpesh në krah të aktorëve të tjerë të njohur si Hasan Dervishi, Llukan Kola dhe Hekuran Zhiti dhe ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me regjisorë të njohur si Kristaq Papa, Gjergj Vlashi dhe Leka Bungo, duke u shfaqur shpesh edhe në ekranin e Radio Televizionit Shqiptar.

***Newsbomb.al i shpreh ngushëllime familjes, miqve dhe kolegëve për humbjen tragjike të njeriut të tyre të zemrës.***

## Sondazh

Poll


## Lexo gjithashtu




E Shtunë 12:43

### "Mora Fjalë" drejt zhdukjes nga interneti, autori kërkon ndalimin e këngës



Kulture & Art

Maliq Lila, pena që shkruante të vërtetën

E Premte 19:33 Newsbomb



Kulture & Art

Skënderbeu - Biri i Zotit, filmi i shumëpritur për heroin tonë kombëtar pritet të shfaqet në 2027 (PROMO)

E Premte 11:23




E Mërkurë 10:29

## ZBULIMI I BUJSHEM/ Del në drite një qytet me 6 mozaikë të shekullit të IV në Qesarat Tepelenë, spikat kompozimi i Erosit (FOTOT E JASHTEZAKONSHME)



Kulture & Art

Në 1968 varri i Sami Frashërit u zhvendos me kërkesë të të birit, historiani shqiptar del me VIDEO: Ja si duket sot vendi ku prehet intelektuali shqiptar

E Martë 21:37 Newsbomb



Kulture & Art

“Profeti i pishinave!” Vijon “saga” e përplasjes Butka-Shanaj, Drejtori i Festivalit të Filmit “lëshon gojën”: Mastrubohesh çdo orë në FB duke e bërë fytyrën si b*thë

E Martë 20:02




E Martë 12:17

## Ilir Butka e akuzoi rëndë "me retorikë harbute", regjisori Mevlan Shanaj godet me reagimin: Më thoni NJË VEPËR TË VETME që ka bërë ky person?! (DEBATI MES ARTISTËVE)









Kulture & Art

"Kinematografinë, e bëre pronë të familjes", plas keq mes artistëve, Ilir Butka nuk kursen regjisorin Mevlan Shanaj: Ke marrë lekët dhe akoma s'ke dorëzuar filmin (REAGIMI)

E Hënë 14:32

Kulture & Art

Helena Kadare feston sot 83 vite jetë, Besiana e uron me foton e veçantë dhe i kujton rininë krah Ismailit të madh (DEDIKIMI)

E Hënë 14:10 Newsbomb




E Premte 21:38

## Bashkia Lezhë hap konkursin mbarëkombëtar letrar "At Gjergj Fishta" (AFATET DHE JURIA)






Kulture & Art

Rikthehet për pesë ditë në Tiranë Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e njeriut, në FOKUS arritjet pas Luftës së Dytë Botërore

E Hënë 10:39

Kulture & Art

Nga Roma në Tiranë, statuja e Deas rikthehet në Parkun Arkeologjik të Butrintit! Gonxhja: Dëshmi e artit dhe trashëgimisë sonë kulturore

E Premte 17:55




E Premte 17:45 Newsbomb




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.